

Angli/ Januzaj tjetër gol për Manchester United

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 21 Dhjetor 2013 23:12



Adnan Januzaj ka shënuar një tjetër gol për Manchester United. Futbollisti nga Kosova i ka bërë të gjithë për vete në Angli me paraqitjet e tij. Në ndeshjen përballë West Ham, 18 vjeçari ka shkelqyer me veprimet e tij dhe me golin që ka shënuar në fitoren 3-1 që skuadra e tij ka marrë. Në momentin kur e ka dërguar topin në rrjetë, Alex Ferguson është ngritur në këmbë për të duartrokitur talentin shqiptar. Për Januzaj ky ishte goli i tretë sezonal tek Manchesteri këtë vit dhe tani ai duket të jetë një nga lojtarët e pacmuar tek skuadra angleze.